



FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

MUKOLITINE A – Shurup 250 mg / 5 ml
MUKOLITINE P – Shurup 100 mg / 5 ml
(Karbocisteinë)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Mukolitine dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Mukolitine
3. Si ta merrni Mukolitine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Mukolitine
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË MUKOLITINE DHE PËRSE PËRDORET

Shurupi Mukolitine përmban lëndën vepruese karbocisteinë. Karbocisteina është një agjent mukolitik. Molekula e karbocisteinës e bllokon kimikisht grupin sulfhidril (-SH), i cili është përgjegjës për vetitë e mukusit. Në këtë mënyrë karbocisteina vepron si mukolitik. Ajo ndikon edhe në sintezën e sialomucinës, duke e shtuar sasinë e kësaj të fundit dhe kështu bën të mundur largimin më të lehtë të sekrecioneve në mushkëri. Karbocisteina e ul hiperplazinë dhe hipertrofinë e zonës që sekretion mukusin dhe në të njëjtën kohë ndikon lokalisht edhe si antiflogjistik. Me normalizimin e sekretimit, karbocisteina ndikon si rregulluese edhe në strukturat e tjera ku formohet mukoproteina, si p.sh.: në aparatën tretës dhe atë urogenital, si edhe në veshin e mesëm. Mukolitine indikohet në mjekimin e çrregullimeve të aparatit të frymëmarrjes, të shoqëruara me sekretim të theksuar të mukusit:

- bronkite,
- astmë bronkiale,
- tuberkulozin e mushkërive i ndërlkuar me bronkit kronik,
- rinit,
- sinuzit,
- laringit.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Mukolitine për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI MUKOLITINE

Mos merrni Mukolitine në qoftë se vuani nga:

- mbindjeshmëria e njohur ndaj karbocisteinës apo ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të shurupit;

- ulçera gastroduodenale aktive;
- glomerulonefrit;
- cistiti akut.

Të mos përdoret tek fëmijët më të vegjël se 2 vjeç.

Tregoni kujdes të veçantë me Mukolitine

Pyesni mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni Mukolitine!
Mukolitine duhet përdorur me shumë kujdes tek të sëmurët me të dhëna për ulçer peptike. Në rastet e hipersekrecionit të theksuar mund të lindë nevoja e thithjes së sekrecioneve trakeobronkiale. Kujdes duhet treguar tek të moshuarit dhe tek personat që marrin njëkohësisht barna që mund të shkaktojnë hemorragji gastrointestinale. Nëse hemorragjia gastrointestinale ndodh, trajtimi duhet të ndërpritet.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Mukolitine. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Mukolitine në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit. Nuk janë vërejtur ndërveprime të karbocisteinës me barnat e tjera. Kujdes duhet treguar tek personat që marrin njëkohësisht barna që mund të shkaktojnë hemorragji gastrointestinale. Nëse hemorragjia gastrointestinale ndodh, trajtimi duhet të ndërpritet.

Marrja e Mukolitine me ushqim dhe pije

Nuk ka të dhëna.

Shtatzënia

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë. Gjatë periudhës së shtatzënisë, ky bar mund të përdoret vetëm në rastet absolutisht të domosdoshme, por rekomandohet të shmanget. Gjithnjë konsultohuni me mjekun tuaj përpara se të përdorni Mukolitine gjatë shtatzënisë.

Ushqimi me gji

Nuk ka të dhëna për përdorimin e Mukolitine gjatë ushqyerjes me gji të foshnjës, gjithsesi si masë paraprake, Mukolitine nuk duhet përdorur gjatë kësaj periudhe.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk janë vërejtur efekte gjatë drejtimit të automjetit dhe përdorimit të makinerive.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Mukolitine

Mukolitine përmban:

- metil parahidroksibenzoat; mund të shkaktojë reaksione alergjike (ndoshta të vonuara);
- sukrozë; nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun përpara se të merrni këtë bar; Mukolitine A përmban 6.75 g sukrozë / 15 ml ndërsa Mukolitine P përmban 5.6 g sukrozë / 12.5 ml, duhet marrë në konsideratë tek pacientët që vuajnë nga diabeti i

sheqerit; sukroza mund të jetë e dëmshme për dhëmbët gjatë përdorimit kronik;

- natrium; Mukolitine A përmban rreth 133.58 mg natrium / 15 ml ndërsa Mukolitine P përmban rreth 41.65 mg natrium / 12.5 ml; duhet të merret në konsideratë nga pacientët që janë duke ndjekur një dietë të kontrolluar me kripëra.

Mukolitine A përmban etanol; mund të jetë e dëmshme për personat që vuajnë nga alkoolizmi. Duhet të merret në konsideratë tek gratë shtatzëna ose që ushqejnë foshnjën me gji, tek fëmijët, dhe grupet me risk të lartë si: pacientët me sëmundje të mëlçisë apo epilepsi.

3. SI TA MERRNI MUKOLITINE

Gjithmonë merrni Mukolitine sipas këshillës së mjekut ose farmacistit. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontakti me mjekun ose farmacistin tuaj. Në qoftë se ndjeni që efektet e Mukolitine janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Mukolitine A – shurup 250 mg / 5 ml

Dozimi është si më poshtë:

Ky bar për të rriturit dhe për fëmijët mbi 12 vjeç, jepet nga goja si shurup në një dozë 750 mg, 3 herë në ditë (15 ml ose 3 lugë çaji shurup, 3 herë në ditë). Doza ulet në 1/3 kur vëreni një përmirësim gjatë trajtimit. Bronkit: Administrimi i karbocisteinës në masën 750 mg tre herë në ditë për 6 muaj ka dhënë përmirësime në funksionin e mushkërive tek pacientët me bronkit kronik, por duket se nuk ka efekt në shpeshtësinë e acarimeve akute. Karbocisteina jep përmirësime në rrjedhën e sputumit.

Mukolitine P – shurup 100 mg / 5 ml

Dozimi është si më poshtë:

Fëmijët e moshës 2 deri 5 vjeç duhet të marrin 50 - 100 mg (2.5 ml – 5 ml), 4 herë në ditë. Ndërsa fëmijët e moshës 5 – 12 vjeç duhet të marrin 250 mg (12.5 ml), 3 herë në ditë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Mukolitine

Në qoftë se keni marrë më shumë Mukolitine se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren. Në mbidozë akute të karbocisteinës, të vetmet simptoma që paraqiten janë çrregullimet gastrointestinale dhe shihet i nevojshëm një trajtim joaktiv, megjithatë duhet të kryhet trajtimi simptomatik.

Në qoftë se harroni të merrni Mukolitine

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a). Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFekte Anësore të Mundshme

Si të gjitha barnat e tjera, Mukolitine mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Mukolitine tolerohet mirë në dozat e rekomanduara. Njoftoni mjekun tuaj për efektet anësore të mëposhtme që mund t'ju shfaqen:

- të përziera;
- dhimbje koke;
- çrregullime gastrike;
- diarre;
- hemorragji gastrointestinale;
- ekzantema;
- reaksione mbindjeshmërie;
- sindromi Stivens – Xhonson.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj. Kur shfaqet ndonjë nga efektet anësore të mësipërme, mjekimi me Mukolitine duhet ndërprerë dhe ju duhet të këshilloheni me mjekun ose me farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI MUKOLITINE

Mbajeni larg fëmijëve!

Mos e përdorni barin pas datës së skadencës të shënuar në paketim!
Ruajeni nën temperaturën 25°C!
Ruajeni në paketimin original për ta mbrojtur nga drita!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Mukolitine A – shurup 250 mg / 5 ml

Lënda vepruese është karbocisteinë.
5 ml shurup përmbajnë 250 mg karbocisteinë.
Përbërës të tjerë: acid citrik monohidrat, hidroksid natriumi, EDTA - dinatriumi, etanol, esencë banane, metil parahidroksibenzoat (nipaginë), sukrozë dhe ujë i pastruar.

Çfarë përmban Mukolitine P – shurup 100 mg / 5 ml

Lënda vepruese është karbocisteinë.
5 ml shurup përmbajnë 100 mg karbocisteinë.
Përbërës të tjerë: acid citrik monohidrat, hidroksid natriumi, EDTA – dinatriumi, etanol, esencë banane, metil parahidroksibenzoat (nipaginë), sukrozë dhe ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit:

Mukolitine A – shurup 250 mg / 5 ml:

Kuti me 1 flakon qelqi me 150 ml.

Mukolitine P – shurup 100 mg / 5 ml:

Kuti me 1 flakon qelqi me 150 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:



Mund të merret pa recetën e mjekut.



Përmbajtja.



Kujdes.



Shurup.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim (MAT) dhe prodhuesi:



PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Mars 2017.

SPECIFICATION



CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATTENTION, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.